Sekuestrohen dhjetëra kallëpe me tritol, armë zjarri, granata dhe kanabis, pranga posedues

18 Shtator, 2025 10:05



Madhësia e tekstit:

Një 68-vjeçar ka rënë në prangat e policisë, pasi në banesën e tij u zbuluan kallëpe me tritol, armë zjarri, granata dhe kanabis.

Gjatë operacionit, në fshatin Gimaj, njësia administrative Shalë, u arrestua shtetasi me inicialet Gj. M.

NJOFTIMI I POLICISË

Finalizohet operacioni policor i koduar "Konglomerat". Sekuestrohen dhjetëra kallëpe me lëndë shpërthyese tritol, armë zjarri, granata, ndezës granatash dhe fitil zjarrpërçjellës.

Vihet në pranga posedues i tyre, i cili në momentin e ndërhyrjes nga Policia u kap në flagrancë duke u kujdesur për 120 bimë narkotike që kishte kultivuar në afërsi të banesës së tij.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Shkodër, bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, se një shtetas posedonte sasi të konsiderueshme lëndë shpërthyese tritol, granata, fitil zjarrpërçjellës dhe armë zjarri, me qëllim për t'ua shitur personave me precedent kriminal që ushtrojnë veprimtari në fushën e krimve kundër personit dhe pronës, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Konglomerat".

Gjatë operacionit, në fshatin Gimaj, njësia administrative Shalë, shërbimet e Policisë vunë në pranga shtetasin Gj. M., 68 vjeç, banues në fshatin Gimaj, Shkodër, pasi në momentin e ndërhyrjes nga Policia, ky shtetas u kap në flagrancë duke u kujdesur për 120 bimë kanabisi që kishte kultivuar në një sipërfaqe toke në afërsi të banesës së tij.

Gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri automatik, municion luftarak, 31 kallëpe tritoli, 110 metër fitil zjarrpërçjellës, 18 granata dore dhe 15 ndezës të unifikuar.

Në vijim të veprimeve procedurale, shërbimet e Policisë asgjësuan me anë të djegies, 120 bimët narkotike të kultivuara në afërsi të banesës së 68-vjeçarit, përveç një pjese që u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Vijojnë hetimet për identifikimin dhe kapjen e shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.
Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme hetimore.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikosh: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Shkodër

TË NGJASHME

Policia aksion edhe në Dajç të Shkodrës, zbulohen parcela me kanabis, 3 të shoqëruar
14 Shtator, 2025

Grabitja e tokave në Velipojë, si u falsifikua prokura e 59-vjeçarës. Pëllumb Gjoka në bashkëpunim me drejtësinë arritë të merta 39 hektarë tokë
15 Shtator, 2025

TaboolaFeed

This 59C Knee Brace gives a New Life to Old Knees
Give your knees the support they deserve with this innovative knee sleeve design for seniors and ...
FlexEase Pro | Sponsored
Buy Now

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Combat Surge | Sponsored
Play Now

FOTO/ "Ushtarakja" 19-vjeçare shpallet vajza më e bukur në botë, s'do ta besoni nga është
FOTO/ "Ushtarakja" 19-vjeçare shpallet vajza më e bukur në botë, s'do ta besoni nga është
balkanweb.com

Most Computer Owners Don't Know This. Do It Today!
This Could Be the Most Important Tip You Read This Year
Outbyte Driver Updater | Sponsored
Click Here

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Po pastronte pas përmbytjeve/ E zë makineria poshtë, humb jetën 38-vjeçari shqiptar në Greq, babai i dy fëmijëve
18 Shtator, 2025

Seanca ndaj Fredi Belerit, gytetari protestë te GJKKO, i drejtohet ambasadores greke: Po mbroni një vrasës!
18 Shtator, 2025

Godit disa herë me shkop gruan duke i shkaktuar vdekjen, i moshuari në Përmet pësoi infarkt (Detajet)
18 Shtator, 2025

Të armatosur në një lokal, me armë gati për qëllje, 2 të arrestuar në Vlorë, dyshohet se do të vrisnin një person. Dalin pamjet e operacionit
18 Shtator, 2025

Pacienti humbi jetën pasi ambulanca e përplasi nga kamioni, policia arreston dy shoferët
18 Shtator, 2025

Sulm seksual ndaj pensionistes gjermane, 60-vjeçari shqiptar kapet pas 20 muajsh, u identifikua nga kamerat e sigurisë
18 Shtator, 2025

KATEGORIA VIDEO

"Shpërton" vetëm Ramadani, fundjavë e errët për legjionarët në Serie A
18 Shtator, 2025

Të armatosur në një lokal, me armë gati për qëllje, 2 të arrestuar në Vlorë, dyshohet se do të vrisnin një person. Dalin pamjet e operacionit
18 Shtator, 2025

Shpërthen çishtja "De Ligt", "tulipanët" kundër Tuchel: Nuk e di pse nuk luaj
18 Shtator, 2025

Beriша përjetoi makthe, Dybala-Lukaku dhurojnë show. Mou Më vjen keq për Empolin
18 Shtator, 2025

Kërkoi ndryshimin e masës së sigurisë, Apeli i Posaçëm lë në burg Fredi Belerin
18 Shtator, 2025

Fitorja në derbi i bën me krahë, por në Itali kanë "zbuluar" elkpin anti-Inter. Ja pse Juve mund të rivalizojë
18 Shtator, 2025

© 2025 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.